



# PlanetAccounting

## Dashboard

1. Çfarë është PLANET ACCOUNTING ONLINE?
2. Modulet
3. Prezantim i shkurtër

## Klientet & Shitjet

4. Shto Klient
5. Elementet e Faturës
6. Shto Fature
7. Shto Arketim
8. Shto Oferte
9. Kupon Fiskal
10. Porosi
11. Kerkes
12. Kthim Malli

## Furnitoret & Blerjet

13. Shto Furnitor
14. Elementët e Faturës
15. Shto Faturë
16. Shto Pagese
17. Shto Oferta

18. Shto Kerkes

19. Shto Porosi

20. Shto Kthim te blerjes

## **Stoku & Sherbimet**

21. Shto Artikull

22. Shto Shërbim

## **Prodhimi**

23. Normativat

24. Urdheresat

25. Prodhimi

## **Punetoret**

26. Shto Punëtor

27. Shto Përdorues

28. Shto Kontratë

## **Pagat**

29. Kalkulimi Pages

## **Bankat**

30. Xhirollogaria

31. Transferet

## **Doganat**

32. Faturë Malli

33. Faturë Transporti

34. IM4

## **Asetet**

35. Shto Aset

## **Konfigurimi**

36. Profili i Kompanis

37. Konfigurimi i Kompanis Shenime

38. Vitet Fiskale

39. Parametrat

40. Elementet e Shabllonit

41. Lokacionet

42. Kalkulimi i pagës

43. importo artikuj me excel

## **Dashboard**

44. Shto Lejim Financiar

45. Shto Lejim Financiar

46. Notë Debitore

47. Notë Kreditore

48. Notë Debitore

49. Notë Kreditore

# Dashboard

## Çfarë është PLANET ACCOUNTING ONLINE?

PLANET ACCOUNTING ONLINE është një zgjidhje afariste e biznesit që ju ndihmon të menaxhoni të gjitha informacionet tuaja të biznesit në një aplikacion dhe ta përdorni jo vetëm për të menaxhuar operacionet, por gjithashtu ju mundëson që të merrni vendime të informuara mirë në kohë për të qëndruar përpara konkurrencës tuaj. Ajo përbën një shtyllë të biznesit tuaj për të shtuar forcën, transparencën dhe kontrollin në ndërmarrjen tuaj.

Qasje revolucionare në mbajtjen e llogarive!

Nuk ka dyshim se teknologjia është kudo dhe mund të sjellë vlera konkurruese. Deri më tani, fusha e IT-së ka pasur një rol esencial në optimizimin e pothuajse të çdo aktiviteti, ka përmirësuar cilësinë e jetës dhe ka ndikuar shumë në sektorin ekonomik. Dekada e fundit është shënuar dukshëm nga paradigma e përdorimit cloud dhe pothuajse çdo fushë ka gjetur një mjet për të përfituar nga përdorimi i saj. Në mënyrë të pashmangshme, informatika cloud ka arritur gjithashtu në fushën e kontabilitetit. Kjo është arsyeja pse bota e kontabilitetit gradualisht po zhvendoset drejt zgjidhjeve të bazuara në cloud. Shfaqja e kontabilitetit në cloud ka provuar të jetë një mënyrë e re për të bërë biznes. Kjo qasje revolucionare në mbajtjen e llogarive është shumë premtuese, pasi ka përparësi të shumta që kontabilistët kanë përjetuar tashmë për shkak të teknologjisë së re.

Sistemi i menaxhimit Online ka ndryshuar mënyrën se si punojmë. Nuk është më diçka që po "vjen në të ardhmen". Sistemi i menaxhimit Online tashmë po përdoret në një larmi të madhe të industrive. PLANET ofron mundësinë për të krijuar një praktikë më të efektshme dhe që u ofron më shumë vlerë klientëve.

Kaloni më pak kohë në punën e pajtueshmërisë. Përqendrohuni më shumë në shërbimet me vlerë të shtuar dhe këshillat e biznesit për klientët.

Kalimi në një sistem online siguron një konfigurim të mirëfillt të kontabilitetit, duke ju lejuar të zgjeroni shërbimet tuaja këshillimore dhe të shtoni vlerë reale.

Me zgjedhjen e Sistemit të kontabilitetit online, një sërë aplikacionesh dhe zgjidhjesh online, ju merrni të dhëna të besueshme në kohë reale dhe mund të përfitoni plotësisht nga puna në sistemin online.

## Si Planet Accounting Online i ndihmon pronarët e bizneseve?

Pronarët e bizneseve mund t'i qasen informatave të tyre në çdo kohë, nga kudo. Pronarët e bizneseve janë gjithmonë në lëvizje dhe gjithnjë e më shumë po përdorin tableta dhe telefona të mençur për të hyrë në të dhënat më të fundit financiare. Me Planet Accounting Online, ata mund të shohin bilanci dhe llogarive të biznesit, faturat e papaguara, pozicionin e përgjithshëm të parasë dhe shumë më tepër nga diku 24/7, për sa kohë që ata mund të kenë qasje në një lidhje interneti.

## Nuk ka rëndësi se a jeni biznesi i vogël apo biznesi i madh!

Nëse po drejtoni një biznes të vogël që ka disa punonjës, kuptoni se është vështirë të menaxhosh natyrën dinamike të bërjes së bizneseve. Bizneset e vogla nuk janë aq të ndryshme nga ato të mëdha. Ato përmbajnë shumicën e kompleksitetit të një biznesi të madh së bashku me shumë kufizime të tjera. Bizneset e vogla duhet të komunikojnë me klientët, të bëjnë llogaritë, të paguajnë taksat, të bëjnë listën e pagave, të menaxhojnë afatet kohore, të japin mallra dhe shërbime cilësore, t'u përgjigjen pyetjeve dhe t'i mbajnë të gjithë të informuar, ashtu si në bizneset e mëdha. Zgjidhja është në PLANET ACCOUNTING.

## Avantazhet e Sistemit PLANET ACCOUNTING ONLINE

PLANET ACCOUNTING ONLINE mund të sigurojë avantazhe të ndryshme për kontabilistët dhe vetë biznesin. Për shkak të mënyrës se si ruhen të dhënat financiare (në serverët e ofruesit dhe jo në një kompjuter lokal) dhe qasja (në internet), të gjithë përdoruesit e përfshirë janë në gjendje të hyjnë në të në çdo kohë, pavarësisht nga vendndodhja e tyre. Kjo është në fakt një nga përfitimet më të rëndësishme të ofruara nga PLANET ACCOUNTING ONLINE, sepse kjo do të përmirësojë bashkëpunimin dhe do të sigurojë përditësimin e të dhënave në kohë reale.

Departamenti i kontabilitetit gjithmonë ka shërbyer për interesin publik, prandaj kontabilistët duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm për përparimet dhe mundësitë që mund të ndihmojnë dhe zhvillojnë profesionin dhe gjithë peizazhin e biznesit.

Me PLANET ACCOUNTING ONLINE parashikimi i saktë mund të bëhet. Kur nivelet e sakta të parashikimit të inventarit mbahen me efikasitet maksimal, kjo lejon që organizata të jetë fitimprurëse.

Integrimi i departamenteve të ndryshme siguron komunikim, produktivitet dhe efikasitet.

Përdorimi i PLANET ACCOUNTING ONLINE çrrënjës problemet dhe koordinimit të ndryshimeve midis shumë sistemeve.

PLANET ACCOUNTING ONLINE ofron një pamje nga lart-poshtë të një organizate, kështu që informacioni është në dispozicion për të marrë vendime në çdo kohë dhe kudo.

## Përfitime të shumëfishta!

PLANET ACCOUNTING ONLINE është bërë një mundësi për të ulur kostot dhe për të rritur produktivitetin për profesionin e kontabilitetit. PLANET ACCOUNTING ONLINE është lojtari i ri ekonomik, që është propozuar për fushën e kontabilitetit. Ky mjet inovativ do të rrisë në mënyrë dramatike aktivitetin e kontabilistëve dhe mund të sigurojë përfitime të shumëfishta për të gjithë partnerët e biznesit, në veçanti për funksionin e kontabilitetit.

# Dashboard

## Konfigurimi

Përmban veçori që kanë efekt të përgjithshëm në fusha të ndryshme brenda moduleve në kuadër të sistemit.

## Paneli lehtë i përdorshëm

PLANET ka ndërfaqe shumë të thjeshtë për përdoruesit që është tepër intuitive dhe i lehtë për të naviguar..

## Shitjet & Klientët

PLANET ACCOUNTING ONLINE ju jep fleksibilitet maksimal, mbi çdo aspekt të proceseve tuaja të shitjes dhe cikleve që nga kontakti i parë me një perspektivë deri tek ata duke u bërë klientë.

## Blerjet & Furnitorët

PLANET ACCOUNTING ONLINE ju jep kontroll të plotë të menaxhimit e zinxhirit tuaj të blerjes dhe të furnizimit. Nga riorganizimi automatik mundëson automatizimin e zgjedhjes së furnizuesit më të lirë dhe ndjekjen e porosive nga transportimi në magazinimin e rafteve tuaja.

## Stoqet & Shërbime

Moduli i stoqeve është një nga modulet më të përdorura në softuerët e kontabilitetit, në veçanti në Sistemin e Avancuar të Kontabilitetit Online "Planet Accounting". Ky modul u mundëson përdoruesve menaxhimit, regjistrimin, modifikimin dhe kontrollin në kohë reale të artikujve dhe depove të biznesit. Nëse jeni prodhues, shitës me shumicë ose shitës me pakicë, menaxhimi i inventarit tuaj është shumë i rëndësishëm për të kontrolluar shpenzimet tuaja dhe për të siguruar funksionimin normal të biznesit tuaj.

## Banka & Arka

Tabela e veprimeve bankare i mirëmban llogaritë e kursimeve dhe çeqeve për kompaninë tuaj, posa të futen të dhënat e kërkuara. Nga kjo tabelë, ju mund t'i futni dhe t'i modifikoni transferet elektronike të fondeve (TEF), mund t'i vendosni llogaritë bankare dhe t'i shihni paratë që i keni borxh dhe paratë që ua kanë borxh. Përdoruesi gjithashtu mund të shkruajë dhe printojë çeqe dhe të harmonizojë llogari bankare.

## Ditari dhe Libri i madh

Ditari - Në ditarin e kontabilitetit pasqyrohen veprimet kronologjike sipas formatit standard të tij.

Libri i madh - përmban të njëjtët veprime si ditari i kontabilitetit, por në këtë rast veprimet

janë të grupuara sipas llogarive.

## Prodhimi

Moduli i prodhimit është një nga modulet më të avancuara në PLANET ACCOUNTING ONLINE. Jep informacionin e kontrollit të prodhimit dhe të informacionit në kohë reale, i cili i lejon përdoruesve evidentimin e të gjitha etapave të një cikli prodhimi.

## RH

Ju mundëson të matni dhe rrisni produktivitetin e punonjësve. Integrimi në kohë reale i punës dhe orari i punës. Detaje të plota dhe sakta të personelit që është plotësisht i integruar me një sistem të plotë të menaxhimit të biznesit dhe të kontabilitetit.

## Pagat

Pagat është një sistem i integruar plotësisht i pagave. Libri i përgjithshëm përditësohet menjëherë duke përfshirë shpenzimet dhe detyrimet e llogarive bankare. Të gjitha lejet, pagesat, zbritjet etj., janë menjëherë të postuara dhe të regjistruara.

## Projektet

Shihni çdo gjë për çdo projekt. Një histori e gjerë dhe e plotë e çdo kuotimi, urdhër shitjesh, faturë, shitje në para të gatshme, deklaratë, emërim, fature, urdhër blerje, kosto etj që keni bërë me këtë punë. Moduli i projekteve ofron mundësinë e mbajtjes së kontabilitetit analitik të projekteve, duke bërë të mundur shpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nëpër projekte të ndryshme.

## Dogana

Shumë kompani blejnë dhe shesin artikuj nga jashtë. Për të gjitha faturat e blerjes nga importi është e mundur regjistrimi i Dokumentit Unik Doganor të lidhur me këto fatura me të dhënat përkatëse mbi taksat e paguara në doganë.

## Asetet

Mundëson krijimin e listës së aseteve të ndryshme, të cilat ju lejojnë të gruponi pasuritë tuaja dhe t'i definoni ato shpejt dhe me lehtësi. Secili grup mund të ketë metodën e vet të zhvlerësimit dhe vlerat që lejojnë përditësimin e të gjitha pasurive brenda grupit shumë lehtë.

## POS!

Asset Plus Online e ka të integruar Point Of Sale "POS" për pikat e shitjeve me pakicë, opsionet e të cilit do t'ju japin kontroll mbi shumë fusha të operacioneve, duke ndikuar në rritjen e kontrollit dhe efikasitetit të biznesit tuaj.

POS ka të integruar të gjitha funksionet të Pika e Shitjes me kontabilitetin në kohë reale.

## Planet MOBILE

Me një numër të shtuar të bizneseve që operojnë në lëvizje, softueri për telefona mobilë është duke u futur me shpejtësi në vendin e punës. Online apo offline, softueri për menaxhim të biznesit tash është në dispozicion në kohë reale në formë të tabletit. Në mënyrë automatike do të sinkronizohet me databazën tuaj të Planet kur të kyçet me internet, apo të azhurnohet në mënyrë automatike kur bëhet lidhja me internet. Planet Mobile ju jep fleksibilitet që të punoni kudo që jeni. Është i shkëlqyeshëm për punonjësit e biznesit që janë në terren dhe u mundëson atyre që t'i menaxhojnë llogaritë e konsumatorëve të tyre shumë lehtë nga cilado pajisje mobile qoftë platformë Android (Aplikacion offline dhe Online), Apple (Online bazuar ne web) apo Windows.

## Raportimi në kohë reale - *Vendime të shpejta dhe të mira*

PLANET operon në kohë reale, kështu që ju gjithmonë e keni mundësin e qasjes së shpejtë në të dhënat e kompanisë!

Planet Accounting e përdorë atë që quhet raportim i transaksioneve në kohë reale, apo ndryshe njihet si sistem i udhëhequr nga të dhënat. Kjo do të thotë që në momentin që futet një transaksion, do të shfaqet menjëherë dhe do ta përshtatë secilin modul që shoqërohet me të, duke përfshirë stokun dhe të gjitha raportet, bilancin, fitimin dhe humbjen, sasitë e stokut etj. Nuk keni më nevojë ta prisni fundin e muajit për azhurnime, raportet e juaja do të jenë të menjëhershme dhe të azhurnuara në një mili sekondë.

PLANET ACCOUNTING ONLINE mundëson gjenerimin e qindra raporteve standarde të biznesit për prodhim, blerje shitje, personel dhe të ndryshme; Të gjitha raportet zyrtare për Administratën Tatimore të Kosovës: Libri i blerjes, Libri shitjes, Formulari i TVSH-së, Lista e pagave, CD, PD, Pasqyrat financiare, Të gjitha raportet zyrtare për Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.

Ju mund të personalizoni ndonjë nga raportet ekzistuese standarde në PLANET ACCOUNTING ONLINE në qindra mënyra të ndryshme. Këto raporte pastaj mund të ruhen dhe të shikohen në çdo kohë. Me një varg pothuajse të pakufizuar të raporteve, duke përdorur printime dhe stile të ndryshme që do të lejojnë një përdorues të krijojë një raport të ri ose të modifikojë çdo raport ekzistues dhe të ruajë si të tyre.

#### SMART

Raporte te mençura

Dërgimi automatik i raporteve në E-mail lidhur me blerjet, KMSH, shpenzimet, fitimin. Tatimet

Porosite automatike

# Dashboard

*Vendi më i mirë për të marrë vendimin e duhur në zgjidhjen e softuerit të kontabilitetit!*

Misioni i jonë është i thjeshtë: Të ju ndihmojmë juve të bëni zgjidhjen e duhur të softuerit të kontabilitetit. Sistemi i Avancuar i Kontabilitetit Online PLANET ACCOUNTING është një softuer i kompletuar i kontabilitetit në përputhje me Legjislacionin Fiskal të Republikës së Kosovës, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Mundëson menaxhimin online në kohë reale të biznesit tuaj, pa marrë parasysh se sa njësi/degë apo depo keni në distancë.

## Plotësisht i integruar

Sistemi Planet Accounting Online shitet i plotë me çdo funksion dhe modul të përfshirë në çdo pako, kështu që kur ta përdorni Sistemi Planet Accounting Online, thjeshtë dhe shpejtë mund ta aktivizoni secilën nga këto module në çdo kohë dhe të filloni ta përdorni atë menjëherë. Me këtë, Planet Accounting siguron që çfarëdo ndryshimi i ndonjë të dhëne në çfarëdo moduli do të ndikojë menjëherë në të gjitha modulet.

PLANET përfshin komplet sistemin bazik të kontabilitetit dhe funksionalitetin që ju do të prisni nga një paketë komerciale. PLANET është sistem i integruar kontabiliteti që mundëson nxjerrjen e shpejtë dhe të saktë të informatave financiare dhe i mundëson klientit që të ketë kontroll të plotë mbi financat e tij.

PLANET kombinon thjeshtësinë, shpejtësinë dhe saktësinë duke ofruar një sistem kompleks që e bënë menaxhimin e kontabilitetit, financave dhe tërë kompanisë në mënyrë shumë më efektive.

PLANET është zgjidhje ideale për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha. PLANET është i dedikuar për aktivitetet e bizneseve nga më të ndryshmet: Shërbimet, Tregtia me shumicë dhe pakicë, Ndërtimtari, Barnatore, Ordinanca mjekësore, Prodhim, Hoteleri, Kolegje, Marketing, Transport, OJQ, Bujqësi, Autoservise, etj.

## Shumë përdorimesh

PLANET mundëson hapjen pa kufi të kompanive, degëve, departamenteve, gjuhëve, valutave dhe përdoruesve.

## Shumë gjuhë

PLANET ju mundëson të shtoni edhe një gjuhë tjetër që ju nevojitet.

## Këmbimi valutor

Mundëson shitjen dhe blerjen nga vendet e huaja. Vlerat fikse të këmbimit valutor për furnizues mund të përcaktohen, po ashtu edhe auto komanda e vlerave të përshtatjes së këmbimit valutor kur bëhet një pagesë. Produktet mundën edhe të paracaktohen me një furnizues, i cili ka vlerë fikse në valutën e furnizuesit, e cila mund të hapet në mënyrë automatike dhe ta përshtatë shumën aktuale të valutës, sipas vlerës së huaj. Përcaktoni shpenzimet dhe koston e importit drejtpërsëdrejti në një zë, në mënyrë që kostoja e përgjithshme e një produkti të dihet duke e përfshirë shpedicionin, doganat dhe detyrimet e importit.

## Llogaritë

Softueri i kontabilitetit të biznesit Planet ju jep maksimum të fleksibilitetit prej krijimit të planit kontabël dhe qendrave të kostos deri te raportimi në kohë reale dhe ju ofron lehtësi në prezantimin grafik të të dhënave. Planet ka të bëjë me të dhënat tuaja të kontabilitetit dhe ofron qasje të lehtë në



raportet e tij që janë shumë të hollësishme. Futuni te Bilanci juaj i Fitimit dhe Humbjes deri te transaksionet individuale në kohë reale. Jepen gjurmë të plota të auditimit për t'i përcjellë të gjitha transaksionet duke siguruar integritet të të dhënave, gjë që është një nga funksionet kyçe të softuerit për kontabilitet.

#### **Plani kontabël**

Plotësojeni listën e llogarive ashtu siç kërkohet për çfarëdo biznesi. Kjo listë mund të shtohet apo të hiqet duke u varur nga kërkesat tuaja të veçanta. Pos kësaj, mund t'ia nisni nga fillimi me serinë tuaj të llogarive, apo thjeshtë e bashkëngjitni një kombinim të të dyjave.

#### **Kodet e taksave**

Softueri i kontabilitetit është i dizajnuar ta minimizojë gabimin njerëzor, duke ju mundësuar që të përcaktoni kode të taksave për produkte dhe llogari, të cilat pastaj Planet me do t'i hapë në mënyrë automatike në çfarëdo transaksioni, në momentin që përzgjidhet llogaria apo produkti. Po ashtu edhe raporti PAB do të azhurnohet menjëherë me transaksionin e ri, i cili është shtuar për shkak të kodit të taksave që tashmë është përzgjedhur.

#### **Gjurmim i plotë i auditimit**

Në softuerë të kontabilitetit është kyç integriteti i të dhënave. Gjurmimi i auditimit do ta gjurmojë secilin ndryshim të bërë në Planet dhe do të raportojë për atë se, për shembull, kush i ka bërë ato ndryshime, kur i kanë bërë dhe çka kanë bërë? Kjo ju jep mundësinë për t'u kthyer te cilido transaksion dhe t'i shikoni ndryshimet.


#### **Mbulimi i kostos**

Janë bërë hulumtime të shumta mbi kthimin e vlerës së investuar që ndërlidhet me koston e instalimit dhe zbatimit të Sistemi Planet Accounting Online si pako e biznesit dhe menaxhimit. Dhe, gjersa kostoja fillestare është një faktor, përfitimet afatmesme dhe afatgjatë janë fantastike dhe nuk duhet të injorohen. Lehtësia e futjes së të dhënave është treguar si përmirësim sinjifikant në efikasitetin e stafit, masa të kursimit të kohës dhe rënie masive e gabimeve në të dhëna. Kur këto kombinohen me atë se sa shpejtë bëhet raportimi i juaj, edhe kontrollimi i biznesit bëhet në mënyrë shumë të shpejtë. Fakti që Sistemi Planet Accounting Online është një pako që i përfshinë përnjëmend të gjitha, kur të dhënat futen njëherë, rrjedhin çdo kund, kursimi i përgjithshëm që bëhet është tejet i madh, edhe atë jo vetëm kursim i parave, por edhe kursim i kohës.


# Klientet & Shitjet

## Shto Klient

### 1. Klikoni tek moduli Klientët & Shitjet



### 1.1 Tek Klientët Klikoni +Shto klient



### 1.2 Plotësoni të dhënat rreth Klientit

1. Tek numri 1 caktoni shtetin(patjetër)
2. Tek numri 2 vendosni nr Unik te Klientit dhe të dhënat tjera plotësohen automatikisht nëse biznesi është i regjistruar
3. Tek numri 3 mund ta vendosni Nr e Biznesit
4. Tek numri 4 mund ta vendosni Nr.Fiskal
5. Tek numri 5 mund ta vendosni Nr. TVSH
6. Tek numri 6 caktoni numrin rendor të klientit i cili gjenerohet vet nga sistemi dhe mund ta ndryshoni
7. Tek numri 7 mund ta caktoni nëse klienti është person fizik në këtë rast JO
8. Tek numri 8 mund ta caktoni nëse klienti është edhe Furnitor dmth nuk keni nevoj ta shtoni si furnitor tek moduli tjetër nëse e shtoni ketu
9. Tek numri 9 Shënoni Emrin Zyrtar (patjetër)
10. Tek numri 10 Shënoni Emertimin në Sistem dmth në planetaccounting(patjetër)
11. Tek numri 11 mund ta shtoni Klientin në sistem nëse nuk keni të dhëna shtes për të shtuar për klientin dhe vazhdojm me të dhënat shtesë

Shteti

Kosovë **1**

Nr. Unik

810233485 **2**

Nr. Biznesit (ID)

**3**

Nr. Fiskal

**4**

Nr. TVSH

**5**

Nr. Klientit \*

**6** 2 ↻

Person Fizik

 **7**

Shto edhe si Furnitor

 **8**

Emërtimi Zyrtarisht \*

**9**

IlamBuduri SH.P.K

Emërtimi në Sistem \*

**10**

IlamBuduri SH.P.K

Adresa

Opsionet

Lokacioni

Bank

Shënime

**11**

Mbylle

+ Shto klient

### 1.3 Të dhënat Shtesë(Adresa)

1. Tek adresa mundë të plotësoni të dhënat shtesë të nevojshme rreth klientit në fjalë si më poshtë dhe kaloni tek Opsionet

Adresa

Opsionet

Lokacioni

Bank

Shënime

Adresa

Qyteti

Prishtinë

Lagje / Fshat

Ulpianë

Adresa

Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Kodi Postar

ZIP

Kontakto

Telefon

+38349420570

Fax

Web

E-mail

ilambuduri@gmail.com

Mbylle

+ Shto klient

### 1.4 Të dhënat Shtesë(Opsionet)

1. Kodi i Tvsh-së për shitje-Cakto kodin me të cilin do ti bëni shitje këtij klienti
2. Llogaria-Cakto llogarin e kontimit për klientin
3. Cakto Valuten
4. Cakto Lokacionin(psh Depo Kryesore nga do ti shitet ktij klienti produkti)
5. Cakto Datën se prej cilës datë është klientë
6. Cakto nëse ka zbritje për këtë klient

7. Cakto afatin pagesës
8. Cakto limitin
9. Cakto numrin e kartelës
10. Zgjedh agjentin nëse klientit i bëhet shitje me agjent në teren
11. Këto të dhëna mund të mos i plotësoni vetëm nëse dëshironi të jeni specifik rreth klientit

| Adresa   | Opsionet                                | Lokacioni                               | Bank                          | Shënime |
|--|---|---|-------------------------------|---------|
| Kodi TVSH-së për shitjes   |   | Llogaria                                |                               |         |
| <input type="text" value="12 - Shitjet e tatashme me normen 18% (18.00%)"/>        |   | <input type="text" value="Zgjedh ..."/> |                               |         |
| Valuta   | Lokacion / Depo                         | Klient që nga                           |                               |         |
| <input type="text" value="EUR € - Euro - Europe"/>                                 | <input type="text" value="Zgjedh ..."/> | <input type="text" value=""/>           |                               |         |
| Zbritja  | Afati Pageses                           | Limiti                                  | Numri i Kartelës              |         |
| <input type="text" value=""/> %  | <input type="text" value=""/> Dite      | <input type="text" value=""/> EUR       | <input type="text" value=""/> |         |
| Agjenti  |   |   |                               |         |
| <input type="text" value="Zgjedh Agjentin"/>                                       |   |   |                               |         |
| <input type="button" value="Mbylle"/> <input type="button" value="+ Shto klient"/> |   |   |                               |         |

## 1.5 Të dhënat Shtesë (Lokacioni)

1. Ktu mundë të caktoni bilancin fillestar të klientit
2. Gjithashtu edhe lokacionin nëse klienti ka pika të ndryshme duke klikuar Shto Lokacion

| Adresa   | Opsionet         | Lokacioni | Bank | Shënime |
|--|------------------|-----------|------|---------|
| Njësitë e palës dhe bilancet fillesatare   |                  |           |      |         |
| Bilanc Fillestar   |                  |           |      |         |
| <input type="text" value=""/>  |                  |           |      |         |
| Njësia   | Bilanc Fillestar |           |      |         |
| <input type="button" value="+ Shto Lokacion"/>                                     |                  |           |      |         |
| <input type="button" value="Mbylle"/> <input type="button" value="+ Shto klient"/> |                  |           |      |         |

## 1.6 Të dhënat Shtesë(Bank)

1. Mund ta Shtoni xhirollogarin Bankare tja caktoni Shtetin,Emrin e bankës,Nr.Llogaris

Llogaritë Bankare

Shteti Bank Nr. Llogarisë

Kosovë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. 23123213123123123213123 +

Mbylle + Shto klient

## 1.7 Të dhënat Shtesë(Shënime)

1. Këtu mundë të vendosni ndoni shënim rrethë këtij klienti dhe klikoni Tek buttoni +Shto Klientë

Diçka rrethë kesaj kompanie

Mbylle + Shto klient

## 1.8 Klienti paraqitet tek Tabela

### Klientët

Llogarite e Arketueshme

Shfaq

10

Kërko:

|  | # | Emri                     |  |
|--|---|--------------------------|--|
|  | 1 | AUTO ZONE CENTER SH.P.K. |  |
|  | 2 | IlamBuduri SH.P.K        |  |


Duke shfaqur 1 deri 2 nga 2 rreshta

# Klientet & Shitjet

## Elementet e Faturës


### 1. Pjesa e parë

1. **Ruaje Auto** - e ruan faturën si draftë automatikisht në mënyr që tju kursej kohën nëse gjat plotësimit të fatures, mund tju ndalet rryma elektrike apo mundë të bjerë interneti ky opsion ju mundëson të vazhdoni aty ku keni mbetur.
2. **Formulari** -Zgjedhni formularin në këtë rast është faturë mund ta përdorni formular tjetër, si pro Kërkesë,Ofertë,dhe të gjith formularët e tjerë të ofruar nga Planetaccounting
3. **Lloji** - Zgjedhni llojin në këtë rastë Gjeneral, mund ta ktheni në faturë Qiraje
4. **Metoda e Pagesës**- kjo shërben për të zgjedhur metoden e pagesës , Me afat pagese apo Kesh, nëse zgjedhet Kesh arkëtimi bëhet automatikisht.



### 1.1 Pjesa e dytë

1. tek numri 1 tek ikona në të majtë mund ta ruani faturën si shabllon periodik dhe jo periodik,Nëse kemi përsëritje të faturës me të njëjtit artikujt për të mos e shtuar qdo her faturen e njejtë mund ta ruajm si shabllon dhe data kur lëshohet kjo faturë e njëjtë mundë të importohet nga icona tek numri 1 në të djathtë.kjo ju kursen kohë dhe mundë dhe parandalon përsëritje të punës së njëjt.
2. **Rivendos**- E pastron formen duket dhe gjithqka mbrenda saj
3. **Te Re**- ju mundëson të filloni një faturë të re
4. **Notë**- ju mundëson tja bashkangjiti një notë kreditore apo debitore faturës
5. **Fshijë**-ju mundëson të fshini një faturë e cila është procesuar më heret dhe ka ndodhur ndoni gabim gjat procesimit të saj
6. **Importo**- ju mundëson të importoni Faturat të cilat ju i keni te ruajtura në excel dhe e keni manualin se si të importoni mbërnda saj



### 1.2 Pjesa e tretë

1. **Konverto**-ju mundëson pro-Faturën ta ktheni në faturë
2. **Printo**-ju mundëson ta printoni
3. **Raporti**- ju mundëson ta shikoni raportin e transaksionit
4. Nëse klikoni tek icon tek numri 1 ju mundë të mësoni shkurtesa të tastaturës për të lehtësuar punën gjat shtimit të faturës
5. Nëse klikoni tel numri 2 ju hapet një dritare në të cilen ju mundë të caktoni se cilat nga elementet dëshironi të shifni ne formularin e faturës dhe cilat doni ti largoni si tek figura më posht(konfigurimi) kjo nuk ndikon se qka do të printohet aktualisht në faturë shërmben vetem

nëse gjërat e pa nevojshme të mos paraqiten ne formularin e faturës. ndërsa ato qe paraqiten në printimin e faturës duhet të ndryshohen tek moduli Konfigurimi/Shabllonet

6. **Të fundit**–Kthen mbrapa faturën draft të cilën keni qen duke e punuar së fundmi

|                                 |    |                                |    |
|---------------------------------|----|--------------------------------|----|
| Barkodi                         | Po | Emri                           | Po |
| Njësia                          | Po | Zbritje                        | Po |
| Zbritja Extra                   | Po | Zbritje Extra 2                | Po |
| Cmimi pas zbritjes              | Po | Kodi i TVSH                    | Po |
| Cmimi me TVSH                   | Po | Vlera pa TVSH                  | Po |
| Vlera e TVSH                    | Po | Llogaria                       | Po |
| Depo                            | Po | Projekti                       | Po |
| Info për TVSH                   | Po | Info për Bilanc                | Po |
| Info për zbritje                | Po | Vlera pa Zbritje               | Po |
| Vlera e Zbritjes                | Po | Vlera pa TVSH - Total          | Po |
| Vlera e TVSH Total              | Po | Punëtori                       | Po |
| Lokacioni                       | Po | Nr. pas pikës decimal - Çmimet | 2  |
| Nr. pas pikës decimale - Vlerat | 2  | Artikujt max. në paraqitje     | 10 |
| Printo listen e paketimit       | Jo |                                |    |

### 1.3 Pjesa e katërt

1. Tek numri 1 nëse keni zgjedhur një klientë apo funitor ju mund ta shikoni profilin e tij duket klikuar tek numri 1
2. Nëse klikoni tek icona tek numri 2 ju mund ta fiksoni atë klient apo furnitor dhe qdo herë qe hapni faturën, paraqitet automatikisht ai klient apo furnitor të cilin e keni fiksuar
3. Tek numri 3 icona search ju mundëson të kerkoni klientë apo furnitor në një dritare të re
4. Tek numri 4 icona plus ju mundë të shtoni një klientë të ri nëse nuk e keni të regjistruar, mund ta bëni nga fatura
5. Tek numri 5 ju mundë të zgjedhni klientin, klientët e regjistruar ju paraqiten automatikisht, gjithashtu ju mund ti kerkoni ata me emertim apo numer unik etj...
6. Tek numri 6 ju paraqiten informacionet shtesë për klientin që e keni zgjedhur.

Klienti

Emri i biznesit, Nr. Fiskal, Nr. i Biznesit, Nr. i TVSH-së

Info Shtes

## 1.4 Pjesa e pestë

1. **Numri Faturës-** ky numer rritet sa her qe shtohet një fatur e re, mundë të vendosni qfardo lloj numri dhe duhet të jetë unik
2. **Data-**Ketu vendoset data se kur është lëshuar kjo faturë
3. **Punëtori-**Nga cili puntorë është lëshuar kjo fatur
4. **Lokacioni-**Nga cili lokacion është lëshuar kjo faturë
5. **Dërgo në email-**Nëse klienti posedon email tek profili i tij atëher faturen mundë të ja dergoni në email
6. **Dërgo në Planet Accounting-**Nëse klienti përdor PlanetAccounting Faturen mund të ja dergoni ne planetaccounting

Numri Faturës \* 1

Data \* 24-03-2021

Punëtori 1 - ilam buduri

Lokacioni Depo Kryesore

Dërgo në email

Dërgo në Planet Accounting

## 1.5 Pjesa e gjashtë

1. **Shifrat-**tek icona search mund të kërkonti artikullin apo mund ta shtypni shifren e tij për gjetje më të shpejtë të artikullit nëse e din shifren e tij
2. **Barkodi-**Paraqitet barkodi i artikullit nëse posedon një barkod,gjithashtu mund ta kerkoni me barkod një produkt
3. **Emërtimi-**Paraqitet emërtimi i artikullit apo mund ta kerkoni artikullin me anë të emërtimit
4. **Njësia-**Paraqitet njësia e artikullit psh COPE,PAKO,KG etj..
5. **Sasia-**Vendoset sasia e shtijes së produktit

| Artikujt       |                      |         |          |        |       |
|----------------|----------------------|---------|----------|--------|-------|
| #              | Shifrat              | Barkodi | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|                | <input type="text"/> |         |          |        |       |
| Sasia Totale : |                      |         |          |        | 0     |

## 1.6 Pjesa e shtatë

1. **Çmimi Bazë-**Vendoset Çmimi Bazë nëse artikullit nuk i është vendosur gjat shtimit
2. **Zbritja-**Vendoset zbritja me përqindje %
3. **Zbritja Ekstra-** Zbritje me përqindje %
4. **Çmimi pa TVSH-** Vendoset Çmimi pa TVSH
5. **Kodi(Norma)-**Zgjedhet kodi i TVSH Psh. kodi 12 = Shitjet të tatueshme me normen 18%

| Çmimi Bazë           | Zbritja | Zbritja Extra | Çmimi pa TVSH | Kodi (Norma)         |
|----------------------|---------|---------------|---------------|----------------------|
| <input type="text"/> | 0       | 0             |               | <input type="text"/> |



## 1.7 Pjesa e Tetë

1. **Çmimi me TVSH**-vendoset Çmimi me TVSH i cili llogaritet automatikisht me çmimin pa TVSH
2. **Vlera pa TVSH**-paraqitet vlera pa tvsh e produktit
3. **Vlera e TVSH**-paraqet vlerën e TVSH-së
4. **Vlera me TVSH**-paraqet vlerën me TVSH

| Çmimi me TVSH | Vlera pa TVSH | Vlera e TVSH-së | Vlera me TVSH |
|---------------|---------------|-----------------|---------------|
| :             |               |                 |               |

## 1.8 Pjesa e nëntë

1. **Llogaria**-Caktohet llogaria psh Shitjet e Stokut(llogarit mund ti modifikoni apo të shtoni të reja tek plani kontabel)
2. **Depo**-Caktohet se nga cila depo shitet produkti
3. **Projekti**- mundë të caktoni Projektin

| Llogaria | Depo | Projekti |   |
|----------|------|----------|---|
| Llogaria | ▼    | :        | + |

## 1.9 Pjesa e Dhjetë

1. Ketu paraqiten Totali i TVSH rreth artikujve nëse kemi artikuj qe shiten me TVSH 18% gjithashtu artikuj me TVSH 8% dhe artikujt pa TVSH
2. Gjithsej për pagesë, pagesat e bëra, borxhi paraprak i klientit për faturat e pa paguara dhe borxhi i mbetur i klientit të caktuar në faturë
3. **Komenti**-informacion detaj rreth kësaj fature

|                      | Vlera | TVSH | Gjithsej për pagesë |      |
|----------------------|-------|------|---------------------|------|
| TVSH 18 %            | 0.00  | 0.00 | Pagesa e bërë       | 0.00 |
| TVSH 8 %             | 0.00  | 0.00 | Borxhi Paraprak     | 0.00 |
| Pa TVSH              | 0.00  | 0.00 | Borxhi i mbetur     | 0.00 |
| Komenti              |       |      |                     |      |
| <input type="text"/> |       |      |                     |      |

## 2.0 Pjesa e njëmbëdhjetë

1. Këtu vendoset kushtet e herëshme të pagesës, afati në të cilën klienti duhet ta paguaj faturën Psh 10 dit nga data e lëshimit të faturës

Kushtet e hershme të pagesës  
Afati përgjithshëm (Net)  Dite


## 2.1 Pjesa e dybëdhjetë

1. Këtu paraqitet Totali i Faturës me të gjith artikujt e vendosur në faturë duke përfshirë TVSH dhe mundë të aplikoni Zbritje ne faturë

|                  |      |   |
|------------------|------|---|
| Vlera pa zbritje | 0.00 |   |
| Zbritja          | 0    | % |
| Vlera e zbritjur | 0.00 |   |
| Vlera pa TVSH ⓘ  | 0.00 |   |
| Vlera e TVSH-së  | 0.00 |   |
| Vlera Totale     | 0.00 |   |

## 2.2 Pjesa e trembëdhjetë

1. Tek Buttoni Të Tjera i cili gjendet në anen e majt në pjesen e poshtme të faturës keni disa mundësi të cilat ju ofrohen Psh ta regjistroni Faturën vetem si Draft, Regjistro & Të re, Regjistro & Klono, Klono
2. Nëse klikoni tek buttoni Lista i cili gjëndet në të djathtë do tju dërgoj direkt tek lista e faturave



## 2.1 Pjesa e katërbëdhjetë


1. Në anën e djathtë pjesa e poshtme e faturës gjenden 2 buttona: Regjistro i cili na mundëson ta regjistrojm Faturën në sistem, dhe Regjistro & Printo i cili na mundëson ta Regjistrojm dhe ta printojm faturën në të njëjtën kohë




# Klientet & Shitjet

## Shto Faturë

### 1. Klikoni tek Moduli Furnitorët & Blerjet



### 1.1 Tek Faturë Klikoni +Shto Faturë



### 1.2 Parakushtet e Faturës

1. Për Shtimin e një Fature së pari duhet të kemi Furnitor të shtuar të cilën mundë ta shtoni direkt nga fatura ose nga moduli i veçant Furnitorët
2. Për të shitur një artikull së pari ai artikull duhet të jetë i shtuar ose mund ta vendosni vetëm emërtimin e tij në faturë nëse produkti apo shërbimi është me emërtim dinamik qe ndryshon sipas nevojës
3. Duhet të keni sasi të mjaftueshme të artikullit nga depoja e caktuar në faturë
4. Nuk mund të shitet një artikull nëse sasia e tij është shtuar psh me 01.01.2021 dhe data e faturës qe doni ta lëshoni është 30.12.2019 sepse në këtë datë sasia e artikullit është zero

**Blerje Fature**

Ruaje Auto Po Formulari Fature Lloji General Rivendos +Të re Korigjo +Notë Fshij Importo Konverto Printo Raporti

Metoda e Pagesës Me afat pagese

Furnitori

NO IMAGE Emri i biznesit, Nr. Fiskal, Nr. i Biznesit, Nr. i TVSH-së

Numri Fatures Data Punëtori Llogaria Depo Dërgo në email

Artikujt

| #               | Shifrat | Barkodi | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi Bazë | Zbritja | Zbritja Extra | Çmimi pa TVSH | Kodi (Norma) | Çmimi me TVSH | Vlera pa TVSH | Vlera e TVSH-së | Vlera me TVSH | Llogaria | Depo | Projekti |
|-----------------|---------|---------|----------|--------|-------|------------|---------|---------------|---------------|--------------|---------------|---------------|-----------------|---------------|----------|------|----------|
| Sasia Totale: 0 |         |         |          |        |       |            |         |               |               |              |               |               |                 |               |          |      |          |

TVSH 18 % Vlera TVSH Gjithsej për pagesë Kushtet e hershme të pagesës Afat i përgjithshëm (Net) Dite

TVSH 8 % Vlera TVSH Pagesa e bërë

Pa TVSH Vlera TVSH Borxhi Paraprak

Komenti Borxhi i mbetur

Vlera pa zbritje Zbritja Vlera e zbritur Vlera pa TVSH Vlera e TVSH-së Vlera Totale

Të Tjera Lista Regjistro Regjist

### 1.3 Shto Klientin në Faturë

1. Tek numri 1 klikoni shigjetën në mënyr që të paraqiten Furnitori ose mund ta kërkonti me emër ,nr. fiskal etj...
2. Tek numri 2 kam zgjedhur Furnitorin duke klikuar mbi të

Furnitori

Caktoni Furnitorin

NO IMAGE

Emri i biznesit, Nr. Fiskal, Nr. i Biznesit, Nr. i

2 AUTO ZONE CENTER SH.P.K. Prizren 0.00

3 IlamBuduri SH.P.K Ulpianë, Prishtinë 0.00

+ Shto "" Enter

### 1.4 Zgjedh Artikullin në Faturë

1. Klikoni tek icona seach për të kërkuar artikullin
2. mund ta kërkonti artikullin me shifer, barkod emërtim gjithashtu

Artikujt

| # | Shifrat | Barkodi | Emërtimi |
|---|---------|---------|----------|
|   |         |         |          |

### 1.5 Zgjedh artikullin

1. Tek numri 1 po e shtoj artikullin duke klikuar tek icona e markuar me të kuqe (mundë të shtoni më shumë se një artikull)
2. Tek numri 2 mbylleni dritaren pasi të keni shtuar artikujt





## Artikujt

×

Artikujt / Shërbimet    Aksionet me Kombinim    Asetet

---

Show:  entries    Search:

| Numrat | Barkodi | Emërtimi                         | Njësia  |
|--------|---------|----------------------------------|---|
| 1-1    |         | PTC Thermistor B59100-M1155-A070 | Cope           |
| 1-2    |         | PTC Thermistor B59100-M1155-A070 | pako           |
| 123    | 440303  | artikulli                        | cope  <b>1</b> |
| 124    | 34343   | artikulli 2                      | cope           |

Showing 1 to 4 of 4 entries    Previous **1** Next

   + Shto Artikull / Shërbim    + Shto **2**    **X Mbylle**

## 1.6 Plotëso të dhënat e artikullit (Pjesa e parë)

1. Caktoni Njësin në këtë rastë Copë (psh, Pako, Palet.kg etj...)
2. Tek numri 1 kam caktuar Sasin e shitjes së këtij artikull
3. Tek numri 2 është Çmimi bazë të cilin e kam caktuar gjat shtimit të artikull të cilin mund ta ndryshoni

### Artikujt

| #              | Shifrat                        | Barkodi | Emërtimi  | Njësia | Sasia      | Çmimi Bazë       |
|----------------|--------------------------------|---------|-----------|--------|------------|------------------|
| 1              | 123                            | 440303  | artikulli | cope   | <b>1</b> 5 | 1.27119 <b>2</b> |
|                | <input type="text" value="q"/> |         |           |        | 0          |                  |
| Sasia Totale : |                                |         |           |        | 5          |                  |

## 1.7 Plotëso të dhënat e artikullit (Pjesa e dytë)

1. Mundë të vendosni zbritjen në përqindje %, zbritjen extra
2. Mundë ta ndryshoni qmimin pa TVSH
3. Tek numri 1 zgjedhni kodin e shitjes në këtë rast kodin 12 mirpo mund të zgjedhni edhe kodet të tjera nëse klikoni tek ikona e markuar me të kuqe ju paraqiten të gjitha kodet e shitjes dhe mund ta zgjedhni atë që ju nevojitet
4. Mund ta ndryshoni qmimin me TVSH ti cili kalkullohet automatikisht

| Zbritja | Zbritja Extra | Çmimi pa TVSH | Kodë (Norma) | Çmimi me TVSH |
|---------|---------------|---------------|--------------|---------------|
| 0       | 0             | 1.27119       | 12 (18.00%)  | 1.50000       |
| 0       | 0             |               | 12 (%)       |               |

## 1.8 Plotëso të dhënat e artikullit (Pjesa e Tretë)

1. Sistemi kalkulon automatikisht -vlera pa TVSH, vlerën e TVSH, vlera me TVSH
2. Tek numri 1 mund të caktoni llogarin, Default është llogaria 4020 Shitjet e Stokut
3. Tek numri 2 caktoni depon se ku gjendet ky artikull dhe sasia e tij

| Vlera pa TVSH | Vlera e TVSH-së | Vlera me TVSH | Llogaria          | Depo      | Projekti |
|---------------|-----------------|---------------|-------------------|-----------|----------|
| 6.36          | 1.14            | 7.50          | 4020 Shitjet e St | D1 - Depo | ...      |
|               |                 |               | Llogaria          |           | +        |

## 1.9 Caktoni kushtet e pagesës deri në cilën datë kjo faturë duhet paguar

Kushtet e hershme të pagesës

Afati përgjithshëm (Net)  Dite

## 2.0 Informacion rreth Faturës

1. Informacion rreth faturës dhe totalit të saj kalkulimet e tvsh, vlera e saj totale, dhe vlera e totale e fatures për të gjithë artikujt që gjenden në faturë

|                  |      |     |
|------------------|------|-----|
| Vlera pa zbritje | 6.36 | EUR |
| Zbritja          | 0.00 | %   |
| Vlera e zbritur  | 0.00 | EUR |
| Vlera pa TVSH    | 6.36 | EUR |
| Vlera e TVSH-së  | 1.14 | EUR |
| Vlera Totale     | 7.50 | EUR |

## 2.1 Fatura Numri, Data

1. Tek numri 1 cakto numrin e faturës
2. Tek numri 2 cakto datën e lëshimit të faturës
3. Tek numri 3 cakto Punëtorin i cili e ka lëshuar këtë faturë
4. Tek numri 4 cakto lokacionin nga është lëshuar fatura
5. Tek numri 5 mund ta dërgoni faturën në email nëse klientit tek informacionet shpesh ja keni vendosur emailin ose mund tja dërgoni në planetaccounting nëse klienti përdor planetaccounting

Numri Faturës \* **1**

Data \* **2**

Punëtori **3**

Lokacioni **4**

Dërgo në email **5**

Dërgo në Planet Accounting

## 2.2 Proceso Faturën

1. Klikoni tek numri 1 regjistro për ta regjistruar faturën
2. Klikoni tek numri 2 regjistro dhe printo për të regjistruar dhe printuar faturën në të njëjtën kohë
3. Pas procesimit të faturës pasi që fatura është me afat pagese ju duhet të bëni Pagsën e faturës tek moduli Pagesë

**Blerje Fature**

Ruaje Auto  Po Formulari Fature Lloji General Rivendos + Të re Korigjo + Notë Fsi

Konverto Printo Raporti Të fundit

Metoda e Pagesës Me afat pagese

Furnitori  IlamBuduri SH.P.K.

Numri Faturës \*  
Data \*  
Punëtori  
Lokacioni  
Dërgo në em

### Artikujt

| #             | Shifrat | Barkodi | Emërtimi  | Njësia | Sasia | Çmimi Bazë | Zbritja | Zbritja Extra | Çmimi pa TVSH | Kodi (Norma) | Çmimi me TVSH | Vlera pa TVSH | Vlera e TVSH-së | Vlera me TVSH | Llogaria |
|---------------|---------|---------|-----------|--------|-------|------------|---------|---------------|---------------|--------------|---------------|---------------|-----------------|---------------|----------|
| 1             | 123     | 440303  | artikulli | cope   | 5     | 1.2711     | 0       | 0.00          | 1.27119       | 43 (18.0%    | 1.50000       | 6.36          | 1.14            | 7.50          | 1520 St  |
|               |         |         |           |        | 0     |            | 0       |               |               | (%)          |               |               |                 |               | Llogaria |
| Sasia Totale: |         |         |           |        | 5     |            |         |               |               |              |               |               |                 |               |          |

TVSH 18 % Vlera 6.36 TVSH 1.14 Gjithsej për pagesë 7.50 Kushtet e hershme të pagesës Vlera pa zbritje

TVSH 8 % Vlera 0.00 TVSH 0.00000 Pagesa e bërë 0.00 Afati 0 Dite Zbritja

Pa TVSH Vlera 0.00 TVSH 0.00 Borxhi Paraparak 0.00 (Net) Vlera e zbritur

Borxhi i mbetur 7.50 Vlera pa TVSH

Vlera e TVSH-së

Vlera Totale


Komenti

Të tjera Lista **1** Regjist


# Klientet & Shitjet

## Shto Arkëtim

### 1. Klikoni tek Klientet dhe Shitjet



### 1.1 Klikoni tek Arkëtim



### 1.2 Zgjedhni Klientin

1. Siq shifet më posht ka zgjedhur klientin i cili ka paguar faturën e caktuar i cili ka psh 7.50 pa paguar të cilen do ta arkëtojm



Shitje Arkëtim

Ruaje Auto  Formulari Pagesë Lloji Arkëtim

Klienti Caktoni Klientin

Emri i biznesit, Nr. Fiskal, Nr. i Biznesit, Nr. i TVSH-së

|   |                                       |      |
|---|---------------------------------------|------|
| 1 | AUTO ZONE CENTER SH.P.K. Prizren      | 0.00 |
| 2 | IlamBuduri SH.P.K. Ulpianë, Prishtinë | 7.50 |

+ Shto "" Enter

Komenti

### 1.3 Lista Faturave

1. Më posht paraqiten Faturat e pa paguara në këtë rast e kemi vetëm 1 fatur të pa paguar vleren e të ciles e vendosim tek Vlera për pagesë

#### Faturat

| Nr. | Data       | Dok. | Nr. Dok. | Njesia | Vlera Fatures | Vlera paguar | Borxhi | Afati i fundit Pageses | Shitësi | Vlera |
|-----|------------|------|----------|--------|---------------|--------------|--------|------------------------|---------|-------|
| 1   | 24-03-2021 | 1    | Faturë   |        | 7.50          | 0.00         | 7.50   | 24-03-2021             |         |       |

### 1.4 Detajet e Arktimit

1. Tek numri 1 vendosni numrin e Pagesës
2. Tek numri 2 vendoset numri i referencës
3. Tek numri 3 vendosni Datën se kur është bërë ky arkëtim
4. Tek numri 4 vendoset se nga kush është bërë ky arkëtim
5. Tek numri 5 vendoset se në qfar lokacioni është bërë ky arkëtim
6. Tek numri 6 vendoset se në cilën llogari do të shkoj ky arkëtim
7. Tek numri 7 vendosni provizion bankar nëse arkëtimi është asisoj

Numri Pagesës \* **1**  ↻

Nr. References **2**

Data \* **3**

Punëtori **4**

Lokacioni **5**

Dërgo në email

|     | Shitësi | Vlera per pagese                 |
|-----|---------|----------------------------------|
| 021 |         | <input type="text" value="7.5"/> |

Arkëtim në **6**

Provizion Bankar **7**

Totali

## 1.5 Regjistro Arkëtimin

1. Pas plotësimit të të gjithë të dhënave rreth arkëtimit klikoni në butonin Ruaj


| Afati i fundit Pageses | Shitësi | Vlera per pagese                 |
|------------------------|---------|----------------------------------|
| 50 24-03-2021          |         | <input type="text" value="7.5"/> |

Arkëtim në

Provizion Bankar

Totali


Regjistro

